



REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTES
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - KANCELARIJA PREDSEDNICE

ZYRA E SEKRETARIT-OFFICE OF THE SECRETARY-KANCELARIJA SEKRETARA

Në mbështetje të nenit 21, 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës merr këtë:

Nr. 7/24
Datë: 25.01.2024

V E N D I M

1. Aprovohet si e bazuar kërkesa për qasje në dokumente publike nga znj. Mediana Halili - "Kallxo.com", drejtuar Zyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës, duke i ofruar qasje në vendimin për dekretimin e Guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës, z. Ahmet Ismaili.
2. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 10, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, Zyra e Presidentes ka pranuar një kërkesë nga znj. Mediana Halili - "Kallxo.com" me nr. të protokollit 01/034-17-01/24, për qasje në vendimin për dekretimin e Guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës, z. Ahmet Ismaili.

Pas pranimit të kërkesës, Zyra e Presidentes, në pajtim me nenin 11, paragrafi 2, të LQDP-së ka shqyrtuar kërkesën, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës, bazuar në kompetencën e saj, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë në Shtyllën për Qasje në Dokumente Publike të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data në të cilën i është dorëzuar vendimi.



Fehmi MEHMETI (ZKA)

Vendimi i dërgohet:

- Znj. Mediana Halili;
- Z. Gentrit Zeqiri, Zyrtar për Qasje;
- Arkivit të Zyrës së Presidentes



REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTIJA
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - PREDSIEDNICA



Nr. i Dekretit: 146/2023

Presidentja e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 84 (4 dhe 27) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 47, 25 janar 2009), nenit 38 (1 dhe 2) të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 77, 16 gusht 2010), si dhe në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 08/V-586, të datës 13.07.2023, për për zgjedhjen e Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, nxjerr:

D E K R E T

1. Z. Ahmet Ismaili emërohet Guvernator i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.
2. Ky Dekret hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Vjosa Osmani - Sadriu

Presidente e Republikës së Kosovës

Prishtinë, më 08 . 08 .2023

Dekreti t'i dërgohet:

1. Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës;
2. Kuvendit të Republikës së Kosovës;
3. Z. Ahmet Ismaili;
4. a/a.